




REPUBLIKA E KOSOVES	REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	D.P.K.
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Nr. I faq.	Prot No
Broj stranica	03-02/346/17
Nr. pages	
02	Date
	Datum
	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-02-2465-17, për Zyrtarin e lartë z.Arben Zharku – Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2465/17, për Zyrtarin e lartë, z.Arben Zharku, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsion i ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Zharku (DPK-03-02-2987-17), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Zharku është dekluaruar se situata për rastin të cilin e ka identifikuar AKK ai ka menduar se ka qenë e rregulluar nga personat përgjegjës, por meqenëse biznesi nuk ka funksionuar ajo çështje, pa dijenin e tij ka mbetë e tille deri në vërejtjen nga Agjencia kundër Korrupsion.

Ndërkohë, z.Zharku, i ka bërë ndryshimet e nevojshme dhe në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë informacionet mbi ndryshimet në biznesin “Qendra Produktion” Sh.P.K. (DPK/Dpki-03-02/3271/17) të bëra në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të

cilin shihet se, z.Arben Zharku tashmë ka hequr dore nga funksioni menaxhues në këtë biznes privat, me çka kashmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zni. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit


/ Shaip Havalli /